

**BRIKENA FURXHI**

**SHTRESIMI HISTORIK I LEKSIKUT NË VEPRËN  
E B. XHAFERIT**

Shtresimi në leksikun e shqipes, sipas studimeve etimologjike, historiko-gjuhësore dallon në visarin leksikor të shqipes fondin indoevropian vetjak të saj dhe elementet jovetjake, të huazuara. Pra, në një **vështrim diakronik** ky sistem leksikor i shqipes dallon burime të ndryshme të huazimeve, të cilat mund të jenë të drejtpërdrejta ose nga një gjuhë e tretë, por edhe një **shtresim kronologjik** të huazimeve në: të vjetra, të mesme, të reja si dhe një shtresim sipas fushave ku është huazuar: në bimësi, vegla, kulturë, etj.

Vetë E. Çabej u kushtoi rëndësi të veçantë jo thjesht ndarjes: fjalë vendi dhe fjalë e huazuar, por edhe elementeve të trashëguara të shqipes, shkallës së asimilimit dhe ngulitjes së huazimeve në shqipen sipas shtrirjes truallsore a stilistike, sipas aftësive fjalëformuese dhe kuptimformuese ose sipas rëndësisë së nocioneve që shënojnë. Si Çabej, edhe albanologë të tjerë të shquar patën luhatjet e tyre në këtë detyrë të vështirë sidomos në huazimet e lashta greke e latine që shqipja i trashëgoi nëpërmjet ilirishtes. Ky studiuës arriti në përfundime të qarta duke bërë një vlerësim cilësor, duke treguar se nuk mund të vihen në një rrafsh e nuk mund të kenë të njëjtën peshë elementet e lashta e të reja, huazimet e formimet më të reja brenda shqipes, elementet e leksikut të përgjithshëm e të periferikut.

Në një vështrim sinkronik brenda këtij sistemi leksikor vihen re zhvillimet e reja, pasurimi i tij i brendshëm e lëvizjet në shtresat e tij. Ky sistem shfrytëzon elemente leksikore të lashta, që dëshmohen që në dokumentet e vjetra të shkrimit të shqipes, elemente leksikore të të folmeve të diasporës apo të dialekteve të shqipes, të cilat kanë sjellë pasurimin e tij. Pra, shtresimi i leksikut shihet në dinamikën e zhvillimit të lëvizjeve të tij në kohë e në hapësirë.

Gjithashtu gjuha jonë që nga Rilindja Kombëtare e këtej është zhvilluar e pasuruar vazhdimisht duke nxjerrë nga përdorimi fjalë a shprehje të vjetruara që kanë dalë nga përdorimi, objektet a sendet që ato shënojnë, fjalë që kanë humbur gjallërinë e mëparshme, duke krijuar kuptime të reja e ngjyime të reja kuptimore të fjalëve të mëparshme. Si rrjedhim, në prerjen diakronike të këtij sistemi leksikor, mund të dallohen tri shtresa:

1. shtresa e përdorimit aktiv të leksikut (fjalë që janë ende në përdorim në gjuhën shqipe)

2. shtresa e leksikut të vjetruar (të ashtuquajturat arkaizma, historizma). **Arkaizma:** nga greqishtja do të thotë “i vjetër”. Jani Thomai në “Leksikologjia e gjuhës shqipe” thotë: “Arkaizmat, fjalë që janë vjetruar a po vjetrohen dhe për

këtë arsye kanë dalë ose po dalin nga përdorimi, duke kaluar nga shtresa aktive në atë pasive të leksikut” (f. 265).

3. shtresa e fjalëve të reja (të ashtuquajtura neologjizma), fjalë që lindin së bashku me realjet e konceptet e reja që ato shënojnë.

Secila shtresë përfshihet në një tekst letrar për të arritur një efekt shprehës. Efekti arrihet në përfshirjen e tyre në një ind veçan a si tufë, për t’i dhënë atij ngjyrim, ose në kontrast me të (Xh. Lloshi, “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika”, Tiranë, 2005, f. 108). Nëse do t’i referoheshim këtij shtresimi historik të leksikut në veprat e B. Xhaferit, kryesisht romanit “Krastakraus” ose “Ra Berati”, tregimeve “Purpuranti” e “Përtej largësive”, në të cilat rrëfëhen luftërat e shqiptarëve nën udhëheqjen e Batos e më vonë të Skënderbeut, do të vëmë re një përdorim të dendur të arkaizmave dhe historizmave prej këtij autori. Edhe pse B. Xhaferi pati pararendës si Barleti, Budi, De Rada, G. Dara, N. Frashëri që shkruan për epokën e Skënderbeut, me veprën e tij ai solli risi në trajtimin e fakteve historike duke i ndërthurur e gërshtuar me përjetimet, ndjenjat e personazheve dhe me elemente të trillit të tij autorial, duke shtuar forcën tërheqëse e ndikuese të veprës së tij te lexuesi. Aty të bien në sy përshkrimet e gjalla të tablove epike të betejave, armatimet e luftëtarëve, veshjet, jeta zakonore, marrëdhëniet feudale, etj., në funksion të të cilave vihet edhe pasuria leksikore e veprës, e cila së bashku me toponimet, antroponimet plotësojnë tablotë e periudhave të caktuara historike. Dy elementet kryesore të këtij leksiku janë arkaizmat dhe historizmat, pjesë e të cilave janë huazimet që i gjejmë si të drejtpërdrejta, kryesisht nga:

- **latinishtja**: mantel, pancir (mburojë), tavernë, principatë, aristokrat, princeshë, abati, fibula (lloj tokëze), legjione, tramundanë (stuhi nga italishtja), principatë, etj.

- **turqishtja**: kuaj dorinj, çili arab, Allah, xherah, era duman (tym), bilan (gjoksore kali), pashai, jeniçer, çallmë, qyrk, dyzet okësh, atllarë, muezini, vasal, axha, ogur, bajrak, gjyryk, bujrum, derman, taksirat, hyxhym, defter, etj.

- **greqishtja**: melhem, karrekllë, kanun, tainë-tainë (taini=1/4 pjesë), dhoga, falanga (njësi ushtarake në ushtrinë maqedonase), mokër, etj. ashtu edhe nëpërmjet një gjuhe tjetër. Kështu gjejmë në vepër huazime që kanë hyrë përmes turqishtes si:

- **me burim pers**: borizan, gjyle, gjynah, xhoka, han, xhanëm, çehre, bahçe, makar, sarhosh, tumane

- **me burim armen**: tamam, hallall, silah (lloj kapuçi), shyqyr, salltanete, gajret, myshterinj, etj.

- **me burim arab**: mashtrapanë (lloj ene), axhamillëqe, hatër.

Arkaizmat me burim autokton të trashëguara nga ilirishtja janë: tumulë, shtrunga, kumi, trrualli, mullis, sokola, borake (mbajtëse), imshtat, fllaskë apo edhe të mëvonshme si: eshka, kukulle (lloj buke misri e trashë, krahinorizëm), qiprave (lloj këmbane e madhe), cangadhe (dele pa qengja), plleja (delja që lind qengj), kmesë (lloj thike), kërqe (lloj thike) etj. Këto huazime u përkasin fushave të ndryshme kuptimore dhe bëjnë pjesë në ligjërimin bisedor. Përzgjedhja e tyre

nga autori ka si qëllim të na tregojë një popull të ndodhur midis dy kulturave: Perëndimit e Lindjes, pasi është i njohur pohimi se historia e një populli pasqyrohet edhe në gjuhën që ai flet. Megjithatë arkaizmat në vepër përbëjnë një numër jo të vogël, të cilat përdoren herë në kuptimet e tyre kryesore, edhe pse të vjetruara e herë me ngjyrim emocionues kryesisht keqësues si mjete stilistikisht funksionale kryesisht për këtë ngjyrim (si p.sh. në publicistikë):

- intelektualët **horra** ... (B. Xhaferi, Vepra 4, f. 41), **berberhana** ku qethet e rruhet politika... (po aty f. 46), **sulltani** sa një ve i Tiranës, duke e shpallur **fermanli** tërë Evropën... (f. 47). Ne nuk bëjmë thirrje **për pelivanllëqe**... (f. 49), besoj se nuk jemi duke rrahur ujë në **havan**... (arkaizëm në përbërje të një frazeologjie, f. 54), me të cilët fillon një monolog **çapraz** akademik... (f. 57). Ky është një **stërçok**, po **derziun** e gënjen mendja dhe e mbante veten për shqiponjë... (f. 59), spiunllëqet e **ustallarëve** të Universitetit shtetëror të Tiranës... (f. 73). Ne nuk duam ta pësojmë si ai që i ra detit **pash më pash** ose të kërrusemi nën hanxharin e turkut... (f. 76), kur kjo gjë të bëhet sa për të larë gojën, sa për **adet**... (f. 79), që t'i dalin zot Shqipërisë në dimër e në **behar**... (f. 81), s'duhet të futni hundët atje pa u lypur **izën** atyre... (f. 81), prrallisnin të krekosur prapa tribunave e mikrofonëve, të kënaqur me tërë atë **kallaballëk**... (f. 82), **dertet** dhe vuajtjet e popullit dhe hallet e problemet e tij... (f. 95), për **hatër** të atyre që na dëftojnë **defteret e hesapeve** të tyre të vjetra akoma të palara... (f. 95), një gazetë e re, një **avaz** i vjetër... (f. 105), le të venë në djall të gjithë ata **dallkaukë** që abuzojnë me idenë e ... (f. 104), i detyronin shqiptarët që të mos kishin rrugë tjetër përveçse të zgjidhnin ose vdekjen, ose **skllavërinë**... (f. 113), shqiptarët kishin mbetur **muhaxhir** udhëve... (f. 114), të gjitha kalojnë në dorën e editorit, pa **imzanë** e tij, asnjë lloj botimi nuk e sheh dot dritën e diellit (f. 117). Marka e fundit e falenderimeve të mendjes së një **kalemxhiu**... (këtu kemi të bëjmë me një kalk/gjedhe). Dolli një **xhelat** grek që nuk njihte mëshirë... (f. 128). Një kope e tërë me **sahanlëpirës** të djeshëm të mbretit... (f. 134), shtypi lokal i Prishtinës ka mbajtur të njëjtin **avaz**... (f. 150) etj.

Në një grup të dytë jo të paktë në numër bëjnë pjesë edhe fjalë të formuara kryesisht me prapashtesim si kalke të formuara me prapashtesa të huazuara si: spiunllëk, baballëkçe, sazexhi, derzi, kallaballëk, kalemxhi.

Këto arkaizma së bashku me frazeologjinë apo devijimet në jo pak fjalë nga standardi drejt dialektit çam, i japin publicistikës të tij ngjyresa emocionale siç shihen edhe vetë në kontekstet e mësipërme ku theksohen notat satirike që përdor autori. Synimi i tij në këto shkrime nuk është të japë thjesht informacione e të sjellë fakte, por edhe të përcjellë gjykimet e tij dhe qëndrimin e tij emocional. Prirja e tij për të përdorur leksik që synon drejt ligjëritimit bisedor përbën një tipar të stilit të Bilal Xhaferit, edhe pse analiza e shtresave leksikore të përdorura në publicistikë ku herë ndërthuren e herë përplasen me njëra-tjetrën arkaizmat me fjalët dhe prurjet e reja leksikore në gjuhën shqipe, do të përbënte një temë punimi më vete.

Pjesa dërrmuese e arkaizmave në veprën e tij në fushën semantike paraqiten të vjetruara në kuptimin kryesor (objekti, sendi, mjeti nuk përdoren më). Në këtë

kategori mund të përmendim edhe arkaizmat historikë, të cilat përbëjnë grupin më të madh të fjalëve të vjetruara. Historizmi është “fjalë a shprehje që ka dalë nga përdorimi i gjallë, sepse sendi a dukuria që shënjon ajo i takon një periudhe historike të kaluar” (FGJSSH, Tiranë, 1980, f. 687). Shkaku kryesor i arkaizmit të këtyre fjalëve është arsyeja historike. Kushtet historiko-shoqërore kanë përcaktuar më shumë se kudo tjetër në gjuhë fatin e këtyre fjalëve të leksikut të shqipes. Në leksikun e përdorur nga Bilal Xhaferri dallohen:

a- **historizma pak të njohura që kanë kufizime dialektore**: kërqe - lloj thike, cangadhët - delet pa qingja, tallaganët - gunë burrash, rrungala - rrymë uji, kobashe - mace, plleja - dele që kanë pjellë, poçe me vere, kmesë - kadhe presëse, vedra me qumësht - gobellë, karroqe (krahin.), shtrungë - vathë, qiprave - këmbora të mëdha, një grusht kokalla (kockash).

b- **historizma ku bëjnë pjesë fjalë me vlerë terminologjike historike** si: farkë, gjyryk, shpata, harqe, shigjeta, jeniçer, sejmen, mueizini, topçinjtë, xhelati, parmendë, mantel, mokra, mashtapanë (lloj ene bakri), borake, pashai, kryqtar, jatagan, topuze, kama, gladiator, etj. ku të bien në sy fjalë të vjetra që i përkasin terminologjisë së luftës (armëve luftarake etj).

Por historizmat në veprën e tij mund t'i grupojmë sipas klasave leksikore me fushat e ndryshme të veprimtarive të jetës si:

1- armët dhe pjesët e tyre, mjetet luftarake dhe emërtime të tjera që lidhen me fushën e ushtrisë si: gjyle, mylli, harqe, shigjeta, shpata, farka, topuz, jatagan, parzmore, ushta, kovaçanë, etj.

2- emërtime nga fusha e etnografisë që shënojnë veshje popullore, pajisje dhe orendi, pjesë ndërtimore si: qyrk, tumane, mallota (gunë burrash), tunika, xhoka, ruba (shami koke), tirqe, fibula, silah (brez), han kanun, konak, tavernë, karrekllë (karrige), orualli, eshka, fllaskë, kmesë, kërqe, parmendë, etj.

3- masat e vjetra të peshës, të sipërfaqes a vëllimit si okë, taini.

4- bimësi: borake plot me **mjedra**, borake e thurur me lëkurë të njomë **krekeze**, **imshtat** e pyllit (shkurmajë), **osaka** (shkurre), **lofata**, **lulekofilat**, **pelini**.

Roli i historizmave në ndërtimin e mjaft njësive frazeologjike, duke mbajtur ngarkesa emocionuese si p.sh.: të ngritura në struktura të tilla i mban gjallë këto fjalë në leksikun e përgjithshëm, duke u specializuar sipas nuancave kuptimore e emocionuese të veçanta në varësi të qëllimit apo përfatesave stilistikore që kërkon të krijojë autori. Arkaizmat ashtu si edhe historizmat funksionojnë në veprën e B. Xhaferit:

1- **Për të dhënë kohën dhe atmosferën historike, por jo vetëm**: Mysafiri tregoi emrin dhe tha se ishte nga Epiri. “Ke dëgjuar fisin epirot të thesprotëve?” - tha. “Thespotët? Posi kam qenë ushtar me romakët atyre armëve. Po-oo! Epiri! Pirrua i madh! Vende të ngrohta të bukura ... vendet tuaja ... i rrëmbyen romakët ... Dhe bari humbi. Dhe pemët e të mbjellat i vrau vrugu. Dhe njerëzit i vrau shpata e shigjeta...” (Përtej largësive, prozë e publicistikë, f. 154).

Menjëherë, te sheshi përpara shpellës u hodhën nga gardhi pesë-gjashtë romakë, dhe, nëpër lesën e hapur hynë dy kalorës të tjerë mbi kuaj dorinj (po aty, f. 156).

## Shtresimi historik i leksikut në veprën e B. Xhaferit

---

Në prozën e tij B. Xhaferi shkon në kohë përtej largësive, përtej epokës sonë, para Krishtit, në periudhën pagane ilire, shkon në kohën e Skënderbeut për të krijuar një portret universal, sa më autentik të shqiptarit, që do të ishte shëmbëlltyrë e adhureshme për bashkëkohësin në rrezikun e tjetërsimit (B. Kuçuku, po aty).

2- **Për të dhënë koloritin e mjedisit:** ata të katërt shtruan përdhe një mushama, vunë mbi të brirët e verës, kukullen dhe, Martini, i ulur në gjunjë, e ndan kukullën tainë-tainë (f. 13).

- Në grykën e Osumit frynte era duman (tym). Berati mezi merrte frymë nga vapa e pashembullt. Garnizoni turk që mbyllur brenda guaskës së mureve të fuqishme të kalasë dhe nga përjashta ishin drejtuar mbi mure grykat e mëdha të topave (f. 13).

Po kam. Kam oruall e eshkë ... Ja po vij... Kam që nga mesi i natës e deri tani që punoj, po tani barin e ka mbuluar vesa e nuk bën të kosis më ... (f. 25).

Veterani i përcolli gjer jashtë te rrapi, duke kërkuar me të lutura, siç e donte mirësjellja, që t'ia bënin hallall, se helbete, nuk mund të kishin mbetur të kënaqur nga ky palo han jo i denjë për mysafirë të tillë të rrallë. (f. 29).

Dëgjohej kudo jehona e këmborëve, zileve dhe qiprave. Dëgjoheshin blegërima, fyej, lehje, vikama (f. 138).

Marashi e kish punuar vetë këtë fyell. Kur delnin të ruanin cangadhet gjer te livadhet e bardha...

3- **Për karakterizimin e personazheve:** ...përpara i doli një fytyrë e huaj, me mjekër si pykë, me tëmtha të gjera, të kërcyera, dhe me një silah që përfundonte përsëri si pykë mbi majë të kokës, mbështjellur me sarrëk të kuq (f. 189).

Edhe veshjet e banorëve kishin një larmi të habitshme. Tirqet e qëndisura me spika, xhoket me thekë si krahë zhgabash, mëngët e gjera të mëngoreve... Me një shije të hollë artistike ishin punuar edhe vogëlsira të tilla të pajisjeve të tij, si dorëza dhe milli i shpatës, mburoja, helmata, shala dhe frerët e kalit (f. 163).

Kjo është shenjë oguri (f. 154). Hasmi i vjetër s'bëhet mik i ri – mërmëriti njëri nga pleqtë që vinin pranë Markut.

Unë nuk dua të bëhem një vasal i gjerë, që as frymë të mos marrë dot pa urdhër nga Kruja – nguli këmbë Leka (f. 29). Ai hapi përkrenaren dhe e vuri te ndenjësja e kroit, hiqi edhe pelerinën dhe e vuri mbi përkrenare (f. 117).

Të shkosh ushtar pas gjithë kësaj hataje që u bë ! Embëta, burra! (mbi ta pra, mbi armikun).

Nëpërmjet përzgjedhjes së qëllimshme të këtij leksiku, ku rolin kryesor e luajnë arkaizmat e historizmat, Bilal Xhaferi synon t'ia shpalosë me sa më shumë vërtetësi lexuesit kontekstin historiko-social të veprës së tij, por edhe në drejtimin e kundërt, për humor dhe ironi duke treguar anakronizmin dhe prapambetjen e asaj eliteje intelektuale shqiptare që dhunoi të drejtat e popullit shqiptar për vite me radhë. Këto arkaizma dhe historizma kanë një shtrirje thujse mbarëshqiptare duke i mbledhur si një gjuhëtar i kujdesshëm në kohë e mjedise të ndryshme për t'i përdorur me mjeshtëri në veprën e tij. Kjo sepse ai nuk kënaqet me paraqitjen e rëndomtë të një sendi, me përshkrimin e thjeshtë të një mjedisi a personazhi, po

kurdoherë do të japë edhe perceptimin e tij vetjak për atë send, mjedis a personazh.

#### **BIBLIOGRAFI**

- B. Xhaferi, *Përtej largësive*, Tiranë, 1996.  
B. Xhaferi, *Vepra* 1, 2, 3, 4, 5, Tiranë, 2010.  
I. D. Hoxha, *Enciklopedi Jug-Shiptare*, Tiranë, 2009.  
J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005.  
J. Thomai, *Rreth shtresimit historik të leksikut të shqipes sipas studimeve të prof. E. Çabejt*, "Studime filologjike", 1988/3.  
K. Sima - B. Keta, *Arkaizmat në shqipen e sotme* etj., "Studime filologjike", nr. 4, 1987.  
P. Margilaj, *Ilirët flasin shqip-shqiptarët flasin ilirisht*, Podgoricë, 2000.  
Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000.  
T. N. Dizdari, *Persizmat në gjuhën shqipe dhe studimi i tyre*, Tiranë, 2010.  
Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2005.  
Xh. Lloshi, *Shkrimtari dhe gjuha*, 1973, 1, "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës".